MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME QYTET SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në SHA Ujësjellës-Kanalizime Qytet Shkodër me objekt **"**Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën nga 01/04/2010 deri më 30/05/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, date 01.06.2000, me shkresën 733/7, datë 28/09/2012 dërguar [redacted], Drejtore e SHA Ujësjellës-Kanalizimeve Qytet Shkodër, me shkresën nr. 733/9, datë 28/09/2012 dërguar [redacted], Drejtore e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe me shkresën nr. 733/8 dërguar [redacted] Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative

1. Asambleja e aksionarëve, Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë të marrin masa për realizimin plotësisht të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Deri më 30.12.2012

2. Bashkia Shkodër në cilësinë e aksionerit të vetëm, të organizojë mbledhjen e Asamblesë së jashtëzakonshme në plotësim të detyrimeve të saja ligjore lidhur me ndryshimin e statutit, si dhe asaj të zakonshme të paktën një herë në vit brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar, duke nënshkruar rregulloren "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA".

Menjëherë

3. Bashkia Shkodër në cilësinë e aksionarit të vetëm, të zgjedhë Këshillin Mbikqyrës sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM nr. 678, datë 3.10.2007 "Për një shtesë në vendimin nr. 271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore".

Menjëherë

4. Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë të analizojnë me përgjegjësi numrin dhe strukturën organike të miratuar dhe të zbatuar, duke nxjerrë përgjegjësinë për tejkalimet e numrit të fuqisë punëtore dhe të hartojë nivele pagash për vende pune me të gjithë elementët përbërës (arsimi, përvoja etj.) si dhe fond pagash sa më real, si një nga zërat e shpenzimeve me peshë të konsiderueshme në koston e furnizimit me ujë.

Deri më 30.12.2012

5. Këshilli mbikëqyrës, Drejtoria e shoqërisë, Dega e financës dhe Dega teknike të bashkërendojnë punën për uljen e detyrimeve debitore dhe kreditore, duke përmirësuar treguesit ekonomiko-financiar.

Vazhdimisht

6. Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë në bashkëpunim me Degën e Financës të bëjë një analizë të hollësishme të detyrimeve fiskale ndaj organit tatimor, për të përcaktuar një strategji të qartë mbi rrugët e mundshme për uljen e tyre deri në likuidimin e plotë.

Deri më 30.12.2012

7. Këshilli mbikëqyrës të marrë masat e nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e auditit të brendshëm të shoqërisë.

Deri më 30.12.2012

8. Drejtoria e shoqërisë të hartojë, miratojë dhe të dërgojë në institucionet eprore programe ekonomiko-financiar me tregues të harmonizuar dhe të bashkërenduar, duke ndjekur të gjitha fazat e përkatëse, si dhe periodikisht të analizojë ecurinë e tyre, duke përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe realizmin e tyre.

Vazhdimisht

9. Drejtoria e shoqërisë të hartojë dhe të zbatojë një program të veçantë masash operative dhe afatmesme lidhur me uljen e humbjeve të ujit të pijshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të raportit arkëtime-faturime.

Menjëherë

10. Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për shmangien e mangësive në hartimin dhe zbatimin e kontratave individuale dhe asaj kolektive, si dhe të sigurojë dokumentacionin personal përkatës për secilin të punësuar.

Deri më 30.12.2012

11. Drejtoria e shoqërisë dhe Dega e financës të marrin masa për printimin e ditarëve, kryerjen e inventarëve, saktësinë dhe qartësinë e dokumentacionit financiar vjetor përmbyllës, si dhe miratimin e pasqyrave financiare në Këshillin Mbikëqyrës.

Menjëherë

12. Drejtoria e shoqërisë dhe Dega teknike të përcaktojnë metoda të qarta dhe të sakta për regjistrimin dhe llogaritjen e prodhimit të ujit, në funksion të analizave për raportet prodhim-faturim-arkëtim uji.

Vazhdimisht

13. Drejtoria e shoqërisë dhe Dega e financës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me diferencat e karburantit në dokumentet e magazinës, si dhe në bashkëpunim dhe me Degën teknike të hartojë një program masash për monitorimin e harxhimit të karburanteve dhe energjisë elektrike.

Menjëherë

14. Drejtoria e shoqërisë të trajnojë nëpunësit e saj që ngarkohen me çështje të prokurimit publik për të thelluar njohjen në hartimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik.

Vazhdimisht

B. <u>Masa për shpërblim dëmi</u>

1. Mbështetur në nenin 113 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me ndryshimet e mëvonshme, nenin 160 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe në Kontratën kolektive të punës të datës 15.03.2009, për 29 persona në **vlerën 790,000 lekë** për përfitim të padrejtë të shpërblimit për festa, të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat sipas listës nr. 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. <u>Masa administrative</u>

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e zhvilluara të prokurimit, përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo procedurë, bazuar në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshimet e mëvonshme, i kërkojmë Agjencisë së Prokurimit Publik **<u>të vlerësojë shkeljet e konstatuara</u>**, duke rekomanduar marrjen e masave administrative dhe/ose disiplinore për:

1. [redacted], Drejtore në detyrë në cilësinë e kryetarit të Autoritetit kontraktor pasi:
- Në kundërshtim me germën "b" të pikës 3 të kreut I të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet për vitin 2010-2012 është dërguar në muajt mars-prill në APP, ndërkohë që duhej të dërgohej brenda datës 15 shkurt të çdo viti.
- Në kundërshtim me shkronjën "d" dhe "dh" të pikës 3 të kreut I të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, autoriteti kontraktor nuk ka raportuar periodikisht realizimin e prokurimeve publike, si dhe nuk ka përgatitur regjistrin e veprimtarive të prokurimit të kryera gjatë vitit paraardhës, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.
- Është përdorur procedura "Me negocim pa botim paraprak të kontratës" në kundërshtim me çështjen iv) të paragrafit të tretë të germës "a", të pikës 5 të kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 me ndryshimet e mëvonshme, duke ulur efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore në tenderat: "Ndërtimi i linjës lidhëse të furnizimit me ujë për dy depot e ujit në stacionin e Dobraçit për njësinë klorinuese", "Lidhja me kanalizime e ujërave të përdorura në Dobraç" dhe "Makineri dhe pajisje".
- Gjatë zbatimit të kontratës së furnizimit me karburant, nuk është zbatuar pika 6.4 e kushteve të veçantë të kontratës, për të kontrolluar cilësinë e mallit të lëvruar në se është njëlloj me atë që është paraqitur në ofertë, para pagimit të faturës së mallit.
- Në kundërshtim me nenin 16-Ekzaminimi dhe pranimi i mallrave, të Kushteve të përgjithshme të kontratës "Blerje makineri dhe pajisje", Autoriteti kontraktor nuk ka kryer ekzaminimin, inspektimin dhe testimin e mallrave me komision të posaçëm teknik, duke shkaktuar mospërputhje të furnizimeve me specifikimet.
- Shtyrja e afatit të përfundimit të kontratës së punimeve "Ndërtimi i linjës lidhëse të furnizimit me ujë për dy depot e ujit në stacionin e Dobraçit për njësinë klorinuese", nuk është në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" të KM, pasi ka ardhur për shkaqe të kontraktorit, nuk është se përmirësohen treguesit e veprës, si dhe nuk ka ardhura nga shkaqe pa mundësisht të paparashikueshme në kohën e duhur.
(Sipas procesverbalit nr. 6, datë 27.07.2012).

2. [redacted] me detyrë Juriste, në cilësinë e kryetares së Njësisë së Prokurimit,

3. [redacted] me detyrë Kryetare e degës së marketingut, në cilësinë e anëtares së Njësisë së Prokurimit,
4. [redacted] me detyrë Inxhiniere në Degën teknike të KUZ në cilësinë e anëtares së Njësisë së Prokurimit pasi:
- Në kundërshtim me germën "b" të pikës 3 të kreut I të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, Regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet për vitin 2010-2012 është dërguar në muajt mars-prill në APP, që duhej të dërgohej brenda datës 15 shkurt të çdo viti.
- Në kundërshtim me shkronjën "d" dhe "dh" të pikës 3 të kreut I të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, nuk ka raportuar periodikisht realizimin e prokurimeve publike, si dhe nuk ka përgatitur regjistrin e veprimtarive të prokurimit të kryera gjatë vitit paraardhës, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.
- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me hipoklorit natriumi me aktivitet deri në 15 % në gjendje të lëngët për dezinfektimin e ujit të pijshëm dhe hipoklorit kalciumi me aktivitet 30-33% në gjendje pluhur për vitin 2012" mungon procedura e përcaktimit të fondit limit, në kundërshtim me shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 2 të kreut II të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar.
- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me karburant gazoil për vitin 2011", përcaktimi sasisë së karburantit për vitin 2011 është bërë mbi bazën e dokumentit pa datë, si dhe të pa nënshkruar nga Kryetari i Degës së Furnizimit [redacted].
- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me karburant gazoil për KUB për vitin 2011", në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore dhe jo të faturave pjesore të kontratave, duke vepruar në kundërshtim me shkronjën "c" të pikës 2 të kreut II të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, si dhe normativat e harxhimit të karburantit nuk janë firmosur nga Kryetari i Degës së Furnizimit [redacted] dhe Përgjegjësi i KUB [redacted].
- Në dosjen e tenderit "Blerje hipoklorit natriumi në gjendje të lëngët, me aktivitet 15 % në sasinë 175,000 kg për dezinfektimin e ujit të pijshëm" janë llogaritur për 175,000 kg, ndërsa shpërndarja në tremujore është bërë për 175,208 kg.
- Në dosjen e tenderit "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për vitin 2011", është lidhur kontrata shtesë me nr. 206/1, datë 14.02.2012, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parafundit të shkronjës "a" të pikës 5, kreu IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, pasi zgjatja e kontratave të shërbimeve ose punëve, bëhet nëse nevoja për punë/shërbime shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor.
- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me karburant gazoil për nevoja të SHA Ujësjellës-kanalizime për vitin 2010", në sasitë e parashikuara për furnizimin me karburant gazoil prej 43,196 litër janë shtuar dhe 9,000 litra të cilat nuk është arritur të tërhiqen nga kontrata e mëparshme, duke arritur gjithsej 52,196 litra, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu II, pika 2 shkronja "ç" për përcaktimin e fondit limit.
- Në dosjen e tenderit "Blerje makineri dhe pajisje", në kundërshtim me shkronjën"c" të pikës 5, të kreut IV të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 i ndryshuar, në urdhrin e prokurimit nr. 102, datë 14.05.2010, autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur arsyet e përdorimit të procedurës "Me negocim pa botim paraprak të kontratës"
(Sipas procesverbalit nr. 6, datë 27.07.2012).

5. [redacted] me detyrë Kryetare e degës teknike, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
6. [redacted] me detyrë Përgjegjëse e degës ekonomike, në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
7. [redacted] me detyrë Përgjegjës për ujësjellësin dhe KUZ, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pasi:

- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me hipoklorit natriumi me aktivitet deri në 15 % në gjendje të lëngët për dezinfektimin e ujit të pijshëm dhe hipoklorit kalciumi me aktivitet 30-33% në gjendje pluhur për vitin 2012", janë pranuar oferta dhe është lidhur kontrata për furnizimin me hipoklorit natriumi me analiza jo në përputhje me specifikimet teknike të tenderit.
- Në dosjen e tenderit "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për vitin 2012" ka vepruar në kundërshtim me paragrafin e fundit të shkronjës "ç" të pikës 4 të kreut V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, duke shkaktuar përdorimin pa efektivitet të shumës prej së paku 169,932 lekë të kësaj kontrate.
- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me karburant gazoil për vitin 2011" është pranuar vërtetimi nga Zyra e Përmbarimit Shkodër me nr. 270 prot., datë 22.04.2011, në emër të [redacted], por për shoqërinë [redacted], për të cilat mban përgjegjësi KVO.
- Në dosjen e tenderit "Blerje hipoklorit natriumi në gjendje të lëngët, me aktivitet 15 % në sasinë 175,000 kg për dezinfektimin e ujit të pijshëm" nuk janë mbajtur në konsideratë shkresa e Drejtorisë së Shëndetit Publik nr. 75. date 17.01.2011 që klorit t'i kryhen dhe analiza të tjera, si dhe niveli më i lartë i klorit aktiv nga 15% përcaktuar në specifikimet teknike të tenderit në 15.4 dhe 15.2%; lidhja e shtesës së kontratës nr. 191/1 prot., datë 05.01.2012 është në kundërshtim me paragrafin e parafundit i shkronjës "a" të pikës 5, kreu IV të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 i ndryshuar, pasi zgjatja e kontratave të shërbimeve ose punëve, bëhet e shkaktuar nga rrethana të paparashikuara.
- Në dosjen e tenderit "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për vitin 2011" nuk ka vepruar në përputhje me paragrafin e fundit të shkronjës "ç" të pikës 4 të kreut V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, duke sjellë nënshkrimin e kontratës me 494,904 lekë më shumë.
- Në dosjen e tenderit "Blerje makineri dhe pajisje", kontrata e lidhur më 08.07.2010, përcakton se lëvrimi i materialeve do të realizohet brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, në një kohë që në DST është vendosur 45 ditë.
(Sipas procesverbalit nr. 6, datë 27.07.2012).

D. <u>MASA DISIPLINORE</u>

a) Mbështetur në pikën 3 të nenit 16 të Statutit tip, të miratuar me VKM nr. 678, datë 3.10.2007 "Për një shtesë në Vendimin nr. 271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore" kërkojmë nga asambleja e aksionerëve të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"<u>Shkarkim nga detyra</u>"*** për:
1. [redacted] në cilësinë e Kryetarit të këshillit mbikëqyrës, pasi:
- Në kundërshtim me pikën 2, kapitulli II- Emërimi i këshillit mbikëqyrës, të Udhëzimit nr. 318, datë 8.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore" të Ministrit të METE, kandidaturat nuk janë shoqëruar me CV-të përkatëse.

- Në zbatim të pikës 1 të nenit 16 të statutit të shoqërisë, miratuar me VKM nr. 678, datë 3.10.2007 “Për një shtesë në vendimin nr. 271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave “për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”, kohëzgjatja e mandatit të këshillit mbikëqyrës është 3 vjet, që do të thotë se që nga data 25.09.2011 e në vazhdim, ky këshill mbikëqyrës vazhdon aktivitetin pa mandatin ligjor të nevojshëm.
- Në kundërshtim me nenin 20 të statutit, këshilli mbikëqyrës nuk është mbledhur njëherë në tre muaj.
- Nuk ka ushtruar kompetencat e veta për të kërkuar nga drejtoria e shoqërisë, informacion mbi ekzekutimin e strategjisë dhe planit të biznesit të shoqërisë. Gjithashtu, lidhur me çështjet e menaxhimit financiar, këshilli mbikëqyrës, nuk ka ekzaminuar dhe kontrolluar librat dhe regjistrat kontabël, dokumentet justifikuese dhe asetet e shoqërisë; nuk i ka paraqitur asamblesë së aksionarëve bilancin kontabël vjetor dhe raportin e performancës së aktivitetit të shoqërisë; nuk ka kontrolluar pagesat e detyrimeve publike, tatimeve dhe taksave siç kërkohet nga ligjet dhe licencat përkatëse; nuk ka kërkuar informacion dhe nuk ka ndërmarrë verifikime mbi baza periodike dhe të përcaktuara, si një instrument mbështetës për të përmbushur objektin e aktivitetit të shoqërisë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.
- Këshilli mbikëqyrës nuk ka krijuar strukturën e auditit të brendshëm i cili raporton tek këshilli mbikëqyrës, në kundërshtim me pikën 6, të Udhëzimit nr. 318, datë 8.04.2009 të Ministrit të METE “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”.
- Në kundërshtim me nenin 8-Asambleja e aksionarëve, të statutit tip të shoqërisë miratuar me VKM nr. 678, datë 3.10.2007, këshilli mbikëqyrës nuk ka thirrur mbledhjen e asamblesë së aksionarëve.
- Në kundërshtim me pikën 3 të nenit 21, të statutit tip të shoqërisë miratuar me VKM nr. 678, datë 3.10.2007, si dhe të shkronjës “c” pikës 6 të kapitullit të I-rë të Udhëzimit nr. 318, datë 8.04.2009 të Ministrit të METE, nuk ka akt emërimi Drejtori i Përgjithshëm dhe nuk është lidhur kontratë me të për detyrimet që rrjedhim në administrimin e shoqërisë, nga kryetari i këshillit mbikëqyrës në emër të Këshillit mbikëqyrës.
- Në kundërshtim me pikën 1 të kapitullit të III të Udhëzimit nr. 318, datë 8.04.2009 të Ministrit të METE, këshilli mbikëqyrës nuk ka hartuar dhe miratuar programin vjetor për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë këshilli apo drejtoria.
- Në kundërshtim me pikën 2 të kapitullit V-Shpërblimi i këshillit mbikëqyrës, të Udhëzimit nr. 318, datë 8.04.2009 të Ministrit të METE, kryetari dhe anëtarët e këshillave mbikëqyrës nuk janë deklaruar vetë me shkrim në drejtorinë e shoqërisë për shpërblimin për pjesëmarrje në këshillin e parë apo të dytë.
- Në kundërshtim me piken 4 të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit te rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA”, këshilli mbikëqyrës nuk ka ndjekur zbatimin e kësaj rregulloreje.
- Nuk ka zbatuar plotësisht masat organizative të rekomanduara nga auditi i mëparshëm.
- Nuk ka marrë në analizë asnjëherë plotësimin e detyrimeve fiskale ndaj organit tatimor për të përcaktuar një strategji të qartë mbi rrugët e mundshme për uljen e detyrimeve deri në likuidimin e tyre, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 21 të statutit tip të shoqërisë të miratuar me VKM nr. 678, datë 3.10.2007.

(Shih procesverbalet nr. 1, datë 23.07.2012; nr. 2, datë 09.07.2012 dhe nr. 5, datë 19.06.2012; Aktverifikimin nr. 1, datë 23.07.2012)

b) Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me ndryshimet e mëvonshme, si dhe në nenin 20 të Kontratës kolektive të punës nënshkruar më 15.03.2009, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna":***

1. [redacted], me detyrë Përgjegjëse e degës ekonomike pasi:

- Në fund të vitit 2010 nuk është bërë printimi i ditarëve me qëllim arkivimin dhe ruajtjen e tyre, në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- Në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2010 nuk është shprehur në lidhje me mospërputhjen e transaksioneve me gjendjen kontabël, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004.
- Nuk është bërë inventarizimi i aktiveve afatgjata në fund të vitit 2010 dhe nuk janë shprehur për këtë në relacionin shpjegues, në kundërshtim me pikën 1të nenit 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004.
- Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2010 nuk janë depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 16 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004.
- Nuk ka respektuar afatet gjatë vitit të pagesës së detyrimeve fiskale në organin tatimor duke u ndëshkuar me gjoba dhe kamatëvonesa në shumën 13,446,079 lekë.
- Pagesa e kompensimit ushqimor nuk është shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm justifikues ligjor, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr.9228, datë 29.04.5004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

(Shih procesverbalin nr. 2, datë 09.07.2012; Aktverifikimin nr.4, datë 23.07.2012; Aktverifikimin nr. 5, datë 17.06.2012)

2. [redacted], me detyrë Përgjegjëse e transportit,

3. [redacted], me detyrë Magazinier, pasi:

- Në administrimin e karburantit për vitin 2010 janë bërë dalja nga magazina 20 litra më shumë karburant se sa hyrje, si dhe për 1390 litra karburant kaluar nga magazina në sektorin e KUB-it, pa dokumentacionin e nevojshëm justifikues të veprimit të kalimit, veprime në kundërshtim me pikën 10 të Udhëzimit nr. 30 të Ministrit të Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Magazinieri, edhe nga mosndjekja si duhet e zbatimit të kontratës "Blerje hipoklorit natriumi në gjendje të lëngët, me aktivitet 15 % në sasinë 175,000 kg për dezinfektimin e ujit të pijshëm", duke pranuar nga kontraktori 1,110 kg hipoklorit natriumi më shumë se kontrata me vlerë 51,520 lekë.

(Shih procesverbalet nr. 3, datë 09.07.2012 dhe nr. 6 të datës 27.07.2012)

4. [redacted], me detyrë Kryetare e degës teknike,

5. [redacted], me detyrë Përgjegjës për ujësjellësin dhe KUZ,

6. [redacted], me detyrë Përgjegjës i stacionit të pompave, pasi:

-Nuk është bërë hartimi dhe zbatimi korrekt i regjimit të prodhimit ujit me qëllim saktësimin e humbjeve, si dhe nuk është monitoruar harxhimi i energjisë elektrike në stacionet e prodhimit, në kundërshtim me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 5, datë 30.10.2009 "Për përcaktimin e objektivave dhe detyrave për çdo departament";

- Mbështetur në pikën 3 të kreut 10 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" me ndryshimet e mëvonshme, për mangësitë në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

- [redacted] ka përdorur metodë të gabuar në përllogaritjen e fondit limit në procedurën e tenderit "Blerje hipoklorit natriumi në gjendje të lëngët, me aktivitet 15 % në sasinë 175,000 kg për dezinfektimin e ujit të pijshëm".
(Shih procesverbalet nr. 3, datë 09.07.2012; nr. 4, datë 23.07.2012 dhe nr. 6, datë 27.07.2012)

c) Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me ndryshimet e mëvonshme, si dhe në nenin 20 të Kontratës kolektive të punës nënshkruar më 15.03.2009 kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"Vërejtje me shkrim":***

1. [redacted], me detyrë juriste, pasi:
- Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2010 nuk janë depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 16 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004.
- Në kundërshtim me germën "b" të pikës 3 të kreut I të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet për vitin 2010-2012 është dërguar në muajt mars-prill në APP, që duhej të dërgohej brenda datës 15 shkurt të çdo viti.
- Në kundërshtim me shkronjën "d" dhe "dh" të pikës 3 të kreut I të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, pasi autoriteti kontraktor nuk ka raportuar periodikisht realizimin e prokurimeve publike, si dhe nuk ka përgatitur regjistrin e veprimtarive të prokurimit të kryera gjatë vitit paraardhës, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.
- Në kundërshtim me nenin 6 të Kontratës kolektive janë marrë në punë 2 punonjës me kontrata individuale me afat të pacaktuar.
(Shih procesverbalet nr. 2, datë 09.07.2012;Nr. 6, datë 27.07.2012; Aktverifikimin nr.5, datë 17.06.2012
2. [redacted] me detyrë Kryetare e degës së marketingut pasi:
- Nuk janë programuar në të ardhurat vjelja e detyrimeve debitore, mungojnë analizat dhe përcaktimi i masave konkrete për përmirësimin e gjendjes ekonomiko-financiare.
(Shih Aktverifikimin nr. 2, datë 18.06.2012)

3. [redacted] me detyrë Ekonomiste e degës së financës, pasi:
- në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" ka bërë likuidimin e faturave të blerjeve me vlera të vogla të pashoqëruara plotësisht me dokumentacionin mbështetës përkatës.
(Shih procesverbalin nr. 4, datë 23.07.2012)
4. [redacted], me detyrë Specialiste e burimeve njerëzore pasi:
- janë lidhur kontratat pa paraqitur më parë dokumentacionin e plotë në përputhje me kërkesat e ligjit.
(Shih Aktverifikimin nr. 5, datë 17.06.2012)
d) Mbështetur në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" neni 56, pika 1, shkronja "c" kërkojmë nga Bordi i mbikëqyrjes publike të ekspertëve kontabël të regjistruar, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore ***"vërejtje me shënim në regjistrin publik":***
1. [redacted], me detyrë eksperte kontabël pasi:
- Në relacionin shpjegues të auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2010, nuk është shprehur për mospërputhjen e transaksioneve me gjendjen kontabël, si dhe për moskryerjen

e inventarizimit të aktiveve afatgjata, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004.
(Shih procesverbalin nr. 2, datë 09.07.2012)

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Gjovalin Preçi**,** Seit Spahiu dhe Gjergji Dhima më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiri, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.